



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:225675
Datë: 24.03.2021
Numri i dokumentit: 01631975

C.nr. 522/2019

GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Arben Xheladini, në çështjen kontestimore të paditëses N.N nga fshati Gernqar, Komuna e Kllokotit, të cilën me autorizim e përfaqëson, Xhavit Haziri, avokat me seli të zyrës në Viti, kundër të paditurës Komuna e Kllokotit, e përfaqësuar nga Lirije Zeqiri-Halabaku, me objekt kontesti pagesa e të ardhurave personale, vlera e objektit të kontestit 3, 489.85 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 11.03.2021, jashtë seance, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet kërkesëpadia e paditëses, N.N, me të cilën ka kërkuar që, e paditura Komuna Kllokotit, të detyrohet që paditëses, t'ia kompensoj të ardhurat personale për 5 muaj e 19 ditë, dhe të përvojës së punës për 35 vite, edhe atë për muajin korrik 2019 shumen prej 535.75 Euro, ndërsa për periudhën gusht-dhjetor 2019 shumen prej 590.82 Euro në muaj, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 3, 489.85 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % në vit e llogaritur nga data e dorëzimit të padisë, e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përmbarrimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

III. Detyrohet paditësja që në emër të taksës gjyqësore të paguajë shumën shtesë prej 20 Euro.

A r s y e t i m

Paditësja N.N, nëpërmjet përfaqësuesit të saj me autorizim, me padinë e datës 09.10.2019, dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga Gjykata, t'ia aprovojë kërkesëpadinë dhe të detyrohet e paditura Komuna e Kllokotit t'ia kompensoj të ardhurat personale për 5 muaj e 19 ditë dhe të përvojës së punës për 35 vite, edhe atë për muajin korrik 2019 shumën prej 535.75 Euro, ndërsa për periudhën gusht-dhjetor 2019 shumën prej nga 590.82 Euro të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 3, 489.85 Euro, me kamatë ligjore prej 8 %, e llogaritur nga data e dorëzimit të padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përmbarrimit.

Pretendimet si në padi, i mbështeti në faktin se paditësja kishte qenë në marrëdhënie të punës te e paditura sipas kontratës së punës, për kohë të caktuar, prej datës së datës 04.07.2019 deri me

31.12.2019, dhe përkundër faktit që gjatë kësaj periudhe kishte punuar në vendin e punës “Doktor i mjekësisë së punës”, e paditura nuk ja kishte kompensuar pagat mujore. Ndërsa, lidhur me pretendimin se e paditura me vendimin 1174/2, të datës 08.07.2019, e kishte anuluar kontratën e punësimit, theksoi të mos i jetë dorëzuar asnjëherë paditëses, dhe për këtë arsye edhe e kishte vazhduar punën deri në ditën e fundit të skadimit të kontratës. Ka propozuar që pas administrimit të provave materiale dhe personale, kërkesëpadia e paditëses të aprovohet si e bazuar, ndërsa e paditura të detyrohet që paditëses t'i kompensojë të gjitha pagat, duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës 104 Euro për përpilim të padisë, për tri seanca nga 135 Euro secila, për ekspertizë 150 Euro dhe 40 Euro për taksën e paguar për padi, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 699 Euro.

E paditura, në përgjigje padi e ka kontestuar kërkesën e paditëses, me arsyetimin se paditëses, me vendimin 1174/2, të datës 08.07.2019, i është anuluar kontrata dhe pas kësaj dite, paditësja nuk ka qenë në punë sipas kësaj kontrate, ndërsa, nuk ka dëshmi të prezencës në punë dhe dërgimit të raporteve të punës, e gjithashtu nuk ka dëshmi që paditësja të jetë takuar me eprorët lidhur me vazhdimin e punës përkundër faktit që kontrata ishte anuluar. Ka propozuar që pas administrimit të provave materiale kërkesëpadia e paditëses dhe kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të procedurës të refuzohen si të pa bazuara, ndërsa i ka kërkuar shpenzimet e procedurës për të paditurën, të cilat nuk i ka specifikuar.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i ka administruar dhe vlerësuar provat materiale të propozuara nga paditësja: Certifikata e Entit Krahinor për mbrojtjen shëndetësore, nr. 548, e datës 10.06.1991, regjistri ditorë për kontrollin e pacienteve dhe kartoni i sigurimit shëndetësor, kontrata e punës 1770/2, e datës 04.07.2019, ekspertizën financiare të datës 07.01.2021, dhe provat materiale të të paditurës: Vendimi nr. 11742, i datës 08.07.2019, Formulari për regjistrimin e punëtorëve në Thesar, Dekalrata nr. 1775, datë 08.07.2019.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses N.N, është e pa bazuar.

Me administrimin e provave materiale, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike:

Me datë 04.07.2019, paditësja dhe e paditura kishin nënshkruar kontratën e punës nr. 1770/2, sipas të cilës, paditësja ishte caktuar në vendin e punës “Doktor i mjekësisë së punës” në ambulanten e fshatit Gërinqar, me 40 orë në javë, me pagë mujore sipas kodit H-27, pikët H-543/1. Me datë 04.09.2019, e paditura e kishte dorëzuar formularin në sektorin e listë-pagesave, i cili nuk ishte aprovuar nga zyrtarja e Thesarit. Me vendimin 1174/2, të datës 08.07.2019, kontrata e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte anuluar nga e paditura, të cilin, paditësja, me rastin e dorëzimit me datë 08.07.2019, kishte refuzuar t'a pranonte, dhe ky vendim ishte kthyer te e paditura me një shpjegim për arsyet e mos dorëzimit të tij. Pas datës 08.07.2019 paditësja nuk ka punuar në vendin e punës sipas kontratës së datës 04.07.2019.

Deklarata e paditëses dhe e dëshmitarit

Në seancën e datës 28.12.2020, është dëgjuar dëshmitari N.N, i cili ka theksuar të mos ketë qenë asnjëherë te paditësja për t'ia dorëzuar Vendimin nr. 1770/2. Lidhur me deklaratën me numër 1775, të datës 08.07.2019, theksoi të mos e ketë shkruar vetë, ndërsa nuk e kontestoi nënshkrimin në fund të kësaj deklarate, me arsyetimin se këtë e ka bërë për ta ruajtur vendin e punës, pasi që i ishte thënë se, nëse e nënshkruan nuk do të kesh' probleme me askend.

Në deklaratën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 28.12.2020, paditësja theksoi të mos e ketë pranuar asnjëherë vendimin me të cilin ishte anuluar kontrata e marrëdhënies së punës, dhe për këtë e kishte vazhduar punën në ambulanten në të cilën ishte punësuar deri në ditën e fundit të kontratës. Kontratën e punës ia kishte sjellur Zoran Cvetkoviç, për të cilin, kishte menduar se është zyrtar financiar në Komunën e Kllokotit, për çka edhe komunikimin rreth çështjes së mos- pagesës së pagave sipas kontratës e kishte bërë me të, dhe sa herë që paditësja e kishte pyetur, ai kishte kërkuar nga paditësja që të pres sepse, paga e parë vonohet. Po ashtu, deklaroi se pasi që kishin kaluar tre muaj dhe nuk e kishte pranuar ende pagën, përsëri e kishte thirrë në telefon Zoran Cvetkoviç, dhe me këtë rast kishte biseduar edhe me Drejtorin e Arsimit, i cili i kishte thënë se do ta rregullojnë këtë çështje. Përfundimisht, në muajin tetor 2019 e kishte takuar përsëri Zoran Cvetkoviç, dhe pas pyetjes lidhur me mos pranimin e pagave, ky i fundit i kishte thënë “e ke kontratën e punës, mundesh me paditë komunën”. Tutje, paditësja theksoi të ketë punuar në vendin e njejtë të punës, deri në përfundimin e kontratës së punës me 31.12.2019. Në fund të deklaratës së saj, paditësja ka theksuar të mos ketë qenë fare në intervistë për vendin e punës në të cilin ishte pranuar dhe lidhur me këtë Zoran Cvetkoviç ja kishte sjellur një dokument të cilin e kishte plotësuar.

Nga provat materiale të adminstruara në shqyrtimin kryesor të çështjes, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesa e paditëses nuk ka bazë ligjore, për shkak se me asnjë provë nuk e ka mbështetur pretendimin se i takon e drejta në pagë për periudhën si në padi.

Fakti i themelimit të marrëdhënies së punës dhe kualifikimet e paditëses, nuk ishin kontestues ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte fakti nëse paditësja e ka pranuar vendimin me të cilin ishte anuluar kontrata e punësimit, e gjithashtu edhe fakti nëse paditësja, pas datës 08.07.2019 deri me 31.12.2019, ka punuar në vendin e punës që ishte pranuar sipas kontratës së datës 04.07.2019.

Nga kontrata e punës, 1770/2, e datës 04.07.2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësja kishte themeluar marrëdhënien e punës te e paditura në pozitën “Doktor i mjekësisë së punës”, në kohë të caktuar, deri me datë 31.12.2019. Me vendimin 1174/2 të datës 08.09.2019, u vërtetua se e paditura, e kishte anuluar kontratën e punësimit të paditëses për shkak se Ministria e Financave – Thesari nuk ka lejuar që kontrata e punës të realizohet, e për këtë nuk do të mund të paguheshin pagat mujore. Fakti i mos regjistrimit të paditëses në listen e pagave u vërtetua nga Formulari i datës 04.07.2019.

Rekrutimi në sektorin publik është i rregulluar me Ligjin e Punës (Ligji Nr. 03/L-212), i cili në nenin 8, par. 1 dhe 2 parasheh “Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.

Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi”.

Siç edhe ka deklaruar vet paditësja, e njejta ka nënshkruar kontratë të punësimit pa qenë fare në intervistë. Edhe pse procedura e pranimit të paditëses në punë nuk ka qenë objekt shqyrtimi në këtë proces kontestimor, është evident se aktin e ‘anulimit’ të kontratës së punës e ka shkaktuar fakti që e paditura nuk kishte pasur sukses që paditësen t’u regjistroj në sistemin e pagave, fakt ky i vërtetuar nga Formulari për regjistrimin e punëtorëve në Thesar, sipas të cilit, zyrtarja që e kishte pranuar këtë formular, te pjesa ‘arsyet e mos aprovimit apo mos procedimin dhe hapat e mëtutjeshëm’ e kishte shënuar vërejtjen konsultim – numri i punëtorëve.

Është evidente se asnjë dispozitë ligjore e Ligjit të Punës nuk përcakton se kontrata e punës mund të anulohet, mirëpo, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, u vërtetua se paditësja e kishte refuzuar pranimin e vendimit 1174/2, të datës 08.07.2019, i cili, me një shënim zyrtar nga N.N, ishte kthyer i pa dorëzuar. Nga kjo datë, konsiderohet se paditësja ka qenë e informuar për veprimet e ndërmarrura nga e paditura, e që ishin me ndikim në marrëdhënien e saj të punës, dhe ka pasur mundësi ligjore që kundër këtij vendimi, fillimisht, të ankohet në procedurë administrative te organet e të paditurës, e pastaj edhe në procedurë gjyqësore, ashtu siç përcaktohet me nein 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Gjykata e vlerësoi edhe deklaratën e dëshmitarit N.N, i cili në shqyrtim gjyqësor mohoi të ketë shkuar te paditësja për t’ia dorëzuar vendimin, e gjithashtu edhe pjesën e deklaratës në të cilën theksoi se kishte qenë i shtyrë për ta nënshkruar dokumentin me numër 1755, të datës 08.07.2019. Kësaj pjese të deklaratës, gjykata nuk ja fali besimin për shkak se, arsyetimit të tij të dhënë në seancë, nuk mund t’i ipet peshë më e madhe në raport me dokumentin e hartuar me shkrim dhe të nënshkruar nga ky dëshmitar. Gjykata nuk ja fali besimin as deklaratës së paditëses në pjesën që theksoi të mos e ketë pranuar vendimin e të paditures e gjithashtu edhe në pjesën se kishte vazhduar punën deri në përfundim të kontratës së punës.

Meqenëse me asnjë provë nuk u vërtetua se paditësja ka punuar nga data 08.07.2019 në vendin e punës sipas kontratës së datës 04.07.2019, nuk i takon as e drejta në kërkesën për pagesën e pagave. Provat e adminstruara lidhur me faktin se paditësja e ka vazhduar punën nuk ishin të mjaftueshme për të mbështetur këtë pretendim. Përkundër që u adminstrua si provë, regjistrit për të cilën paditësja pretendonte se ka kryer kontrolla të pacienteve, gjykata nuk ja fali besimin për shkak se ishte një fletë e thjeshtë e formatit A4 dhe nuk kishte llogo zyrtare apo ndonjë shënim tjetër për të vërtetuar se ky dokument ishte dokument zyrtar i ambulantes në fshatin Gernqar.

Sipas nenit 55, par 1 dhe 2 të Ligjit të Punës “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit. Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”. Sipas kësaj, e drejta për kompensimin e pagës lind vetëm nëse punëtori i kryen detyrat e punës sipas kontratës së punës.

Sipas nenit 7.1 të LPK “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Sipas kësaj dispozite, barra e të provuarit për vërtetimin e të drejtës në pagë, ka qenë e paditëses, andaj kërkesa e saj që e paditura të detyrohet t’ia paguaj shumën e të hollave prej 3, 489.85 Euro, u refuzua si e pa bazuar në ligj, për shkak se paditësja me asnjë provë nuk e mbështeti pretendimin se pas datës 08.07.2019 kishte punuar në vendin e punës sipas kontratës se datës 04.07.2019.

Gjykata administroi edhe prova të tjera materiale, por të njëjtat nuk i arsyetoi veç e veç, pasi që ishin pa ndikim në vendosjen e ndryshe të kësaj çështje.

Lidhur me shpenzimet e procedurës u vendos sipas nenit 450, nenit 452 lidhur me nenin 463 të LPK, pasi që paditësja e humbi kontestin, ndërsa e paditura nuk i specifikoi se cilat shpenzime duhet t’i kompensoh, ndërsa lidhur me taksën gjyqësore, gjykata duke bazuar në nenin 6.2 të UA.Nr.01/2017 për unifikimin e taksave gjyqësore, e obligoi paditësen që të paguajë shumën shtesë prej 20 Euro pasi që, me rastin e paraqitjes së padisë ka paguar vetëm 20 Euro, ndërsa, vlerën e kontestit e ka përcaktuar në shumë prej 3, 489.85 Euro. Në bazë të nenit 12.1 të udhëzimit të lartcekur, për kërkesat në para vlera e të cilave është ndërmjet shumës 2, 501 deri 5, 000 Euro, taksa për padi është 40 Euro, andaj, paditësja edhe u detyrua të paguajë shumën shtesë.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të kësaj aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
C.nr. 522/19, datë 11.03.2021

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër kësaj aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, duke llogaritur pas ditës së pranimit të kësaj vendimit. Ankesa eventuale dorëzohet përmes kësaj gjykate.